



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE FINANCIARE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

V<sub>o</sub> 819

UDHËZIM

01/20.01.2015

Nr..... 4 , Datë ...../01/2015

**“PËR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE TATIMORE TË NJËSIVE TË QEVERISJES  
SË PËRGJITHSHME NGA SISTEMI INFORMATIKË FINANCIAR I QEVERISË PA  
LËVIZJE MONETARE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 171 “Pagesat ndërmjet njësive të qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, Ministri i Financave;

**UDHËZON**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen në procesin e realizimit të pagesave të detyrimeve tatimore të njësive të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet Sistemit Informatikë Financiar të Qeverisë duke përdorur metodën e transfertave të brendshme, e cila eliminon lëvizjen monetare nëpërmjet sistemit bankar.
2. Procedura e punës që do të ndiqet për realizimin e procesit sipas pikës 1, duhet të sigurojë përputhshmërinë me metodologjinë kontabile dhe metodologjinë e menaxhimit të debitoreve të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

**II. PALËT PËRFSHIRËSE NË KËTË PROCES**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare (DPSHF)
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
3. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI)
4. Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (NjQP)

### III. PROCEDURA E PUNËS

#### a- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

1. DPT gjeneron nga sistemi tatimor, në fillim të çdo muaji, numrat serial të deklaratave tatimore për detyrimet tatimore të NjQP-ve dhe dërgon informacionin në DPSHF sipas formatit elektronik të testuar dhe miratuar nga të dyja palët. (Shtojca bashkëngjitur)
2. DPT merr mbi baza ditore nga DPSHF skedarin e pagesave të kryera në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë sipas formatit elektronik të testuar dhe miratuar nga të dyja palët (Shtojca bashkëngjitur) dhe e importon atë në sistemin tatimor. Në rastet e gabimeve të formatit të skedarit DPT njofton brenda ditës DPSHF për korrektimin e tyre. DPSHF brenda një dite pune dërgon në DPT skedarin me të dhënat e korrigjuara.
3. DPT merr mbi baza ditore nga DPSHF raportin e pagesave të ekzekutuara nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë në formën e një përmbledhëse ditore.
4. DPT në bazë të informacionit sipas pikës 2 dhe 3 të këtij seksioni, kryen rakordimet lidhur me menaxhimin e debitorëve dhe kontabilizimin e transaksioneve në sistemin tatimor.
5. DPT, mbas realizimit të procesit sipas pikës 4 të këtij paragrafi, krijon dhe dërgon mbi baza ditore në DPSHF skedarin e konfirmimit të pagesave sipas formatit elektronik të testuar dhe miratuar nga të dyja palët (Shtojca bashkëngjitur).
6. Në lidhje me transaksionet e realizuara nëpërmjet metodës së pagesës sipas këtij Udhëzimi, për efekt të raportimit të brendshëm të të ardhurave, Dega e Thesarit Tiranë do të bëjë akt-rakordimin për periudhën raportuese me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

#### b- Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

1. NjQP-të, çdo fillim muaji, sipas afateve të përcaktuara me ligj, deklarojnë elektronikisht në sistemin tatimor detyrimin mujor për të gjitha llojet e tatimeve që ato mund të kenë.
2. NjQP-të, pas realizimit të procesit sipas pikës 1 të këtij seksioni, gjenerojnë elektronikisht nga sistemi tatimor urdhër pagesën tatimore, e cila përmban numrin serial të deklaratës tatimore të vendosur nga sistemi tatimor.
3. NjQP-të paraqesin në degën e thesarit përkatëse urdhër shpenzimin për tatimin duke i bashkëngjitur, në dy kopje, urdhër pagesën tatimore të gjeneruar nga sistemi tatimor sipas pikës 2 të këtij seksioni.

4. Në rastin e pagesave të pjeshme të shumës së detyrimit, NjQP do të bashkëngjisë, në dy kopje, të njëjtën urdhër pagese tatimore të gjeneruar nga sistemi tatimor për çdo urdhër shpenzim të veçantë të paraqitur në degën përkatëse të Thesarit.
5. NjQP-të rakordojnë çdo muaj me degën e Thesarit përkatëse për pagesat e shpenzimeve sipas pikës 3 të këtij seksioni.
6. Në rastet e krijimit të një NjQP-je të re ose në rastet e ndryshimit të NIPT-it, NjQP-ja i njofton zyrtarisht degës përkatëse të Thesarit numrin e NIPT-it të krijuar për këtë njësi nga DPT e të konfirmuar nga kjo e fundit. Dega e Thesarit përcjell informacionin në DPSHF pranë Ministrisë së Financave.

#### **c- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare**

1. DPSHF regjistron dhe mirëmban kodet e NIPT-eve të NjQP-ve në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë pasi ka marrë konfirmimin nga DPT për saktësinë e kodit NIPT.
2. DPSHF importon në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë të dhënat e skedarit për numrat serialë të deklaratave tatimore të NjQP-ve të dërguara nga DPT sipas pikës 1 të seksionit a) të këtij Udhëzimi. Në rastet e gabimeve të formatit të skedarit DPSHF njofton menjëherë DPT për korrektimin e tyre brenda një dite pune.
3. Degët e Thesarit në rrethe (TDO), pranojnë dokumentacionin lidhur me urdhër shpenzimit mbi detyrimet tatimore të paraqitura nga NjQP-të me të cilat ato operojnë.
4. Dega e Thesarit nuk do të pranojë dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij seksioni, nëse atij nuk i është bashkëngjitur urdhër pagesa tatimore përkatëse sipas pikës 3 dhe 4 të seksionit b).
5. Dega e Thesarit kryen kontrollet përkatëse të dokumentacionit dhe atë të fondeve buxhetore në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë.
6. Nëse kontrollet përkatëse sipas pikës 5 të këtij seksioni kryhen me sukses, dega e Thesarit procedon me regjistrimin e ditarit të shpenzimit në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë. Në rast të kundërt, njoftohet NjQP-ja përkatëse për motivin e refuzimit të kërkesës për shpenzim.
7. Procedura e realizimit të transaksioneve të brendshme në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë do të kryhet mbi bazën e manualit të përdorimit të hartuar për këtë proces: “Manuali i përdorimit për ekzekutimin e pagesave të detyrimeve tatimore të NjQP-ve në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë pa lëvizje monetare”.

8. Pas regjistrimit dhe postimit të ditarit të shpenzimit, specialisti i shpenzimeve në degën e Thesarit regjistron në dokumentin fizik të urdhër pagesës tatimore të paraqitur nga NjQP numrin e dokumentit të ditarit të krijuar automatikisht nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë gjatë procesit të postimit. Një kopje të urdhër pagesës tatimore, Dega e Thesarit i'a jep NjQP-së.
9. Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë kryen vlerësimet teknike të ditarëve të shpenzimit të krijuar sipas pikës 7 të këtij seksioni lidhur me numrat serialë të deklaratave tatimore dhe NIPT-ve të NJQP-ve, në përputhje me zgjidhjen teknike të miratuar nga palët (DPSHF, DTI dhe DPT) për realizimin e këtij procesi.
10. Nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë krijohet dhe dërgohet mbi baza ditore në DPT skedari i pagesave të kryera dhe raporti përmbledhës ku janë të përfshira lëvizjet ditore sipas pikës 2 dhe 3 të seksionit a) të këtij Udhëzimi.
11. DPSHF merr mbi baza ditore nga DPT skedarin elektronik të konfirmimit të pagesave sipas pikës 5 të seksionit a) të këtij Udhëzimi, të cilin e importon dhe kryen rakordimet e transaksioneve që përmban ky skedar në Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë. Në rastet e gabimeve të formatit dhe të dhënave të skedarit DPSHF njofton menjëherë DPT për korrektimin e tyre (brenda një ditë pune).
12. Degët e Thesarit në rrethe njoftojnë dhe rakordojnë sistematikisht me NjQP-në përkatëse mbi ekzekutimin e buxhetit lidhur me këtë proces.

### III. TË TJERA PËRCAKTIVE

1. Mënyra e komunikimit ndërmjet DPT-së dhe Ministrisë së Financave (MF) për shkëmbimin e të dhënave elektronike realizohet si më poshtë vijon:
  - Lidhja ndërmjet DPT dhe MF kryhet nëpërmjet linjës GoV NET. Në serverin FTP SERVER të MF është krijuar përdoruesi DPT, i cili ka akses në direktorinë e përcaktuar për transferimin e deklarimeve elektronike.
  - DPT dërgon skedarin e serialeve të deklaratave elektronike nga serveri i DPT në Serverin FTP SERVER të MF duke përdorur rrjetin GoV NET.
  - MF merr skedarin elektronik të serialeve të deklaratave tatimore në FTP SERVER dhe i kalon në mënyrë automatike në serverin e Sistemit Informatikë Financiar të Qeverisë.
  - Skedari i deklaratave tatimore procesohet në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë duke shërbyer si bazë për gjenerimin e pagesave elektronike ITC (Internal Tax Clearing).

- MF transferon nga serveri i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë në FTP Server pagesat elektronike ITC (Internal Tax Clearing).
  - Skedari i pagesave elektronike ITC (Internal Tax Clearing) dërgohet nga serveri i MF FTP SERVER drejt serverit të DPT nëpërmjet Linjes GoV NET.
  - DPT pasi proceson skedarin e pagesave elektronike ITC (Internal Tax Clearing) të dërguara nga MF dërgon drejt MF skedarin e kofirmimit të pagesave elektronike.
2. Formati i skedarëve elektronike të komunikimit ndërmjet sistemit të DPT dhe Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë paraqiten në aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi, respektivisht për:
- Skedari elektronik i numrave serial të deklarave tatimore të gjeneruara nga sistemi tatimor.
  - Skedari elektronik i pagesave tatimore të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.
  - Skedari elektronik i kofirmimit të pagesave i gjeneruar nga sistemi Tatimor për pagesat e kryera në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.
3. Udhëzimi Nr.10 datë 30.04.2012 “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi tatimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të njësive të qeverisjes së përgjithshme nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë pa lëvizje monetare”, shfuqizohet.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**SHKËLQIM CANI**



---

**MINISTËR**